



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

PËR

**MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË AKADEMISË SË STUDIMEVE
ALBANOLOGJIKE DHE RIORGANIZIMIN E NJËSIVE KRYESORE
TË SAJ**

**I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË
SYNOHEN TË ARRIHEN**

Akademia e Studimeve Albanologjike (ASA) është krijuar me vendimin nr. 559, datë 22.08.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për bashkimin e disa instituteve të Akademisë së Shkencave, organizimin e tyre në Qendrën e Studimeve Albanologjike, si dhe funksionimin e kësaj qendre në periudhën kalimtare”, i ndryshuar.

Akademia e Studimeve Albanologjike funksionon sipas statutit të miratuar me urdhrin nr. 296, datë 29.5.2018, të ministrit të MASR, “Për miratimin e statutit të Akademisë së Studimeve Albanologjike”.

Ministria përgjegjëse për arsimin është institucioni që realizon programin qeverisës në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

Në bazë të shkronjës “e” të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ministria përgjegjëse për arsimin në ushtrim të kompetencave të saj ligjore, kontrollon pajtueshmërinë e veprimtarisë së institucioneve të arsimit të lartë me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Në kuadër të ushtrimit të këtij kontrolli ligjshmërie nga Ministria përgjegjëse për arsimin, në të gjitha institucionet e arsimit të lartë, rezultoi që ASA nuk

përbushte kërkesat ligjore që lidhen me organizimin institucional, duke mos funksionuar si një institucion i arsimit të lartë i llojit “Akademi”, sipas kritereve ligjore të përcaktuar në nenin 19 të ligjit nr. 80/2015, nuk përmbush detyrimin ligjor për realizimin e procesit të akreditimit, i cili përbën një proces të pavarur për vlerësimin e jashtëm të cilësisë, që përcakton nëse institucioni i arsimit të lartë dhe/ose programet e studimit, që ai ofron, përmbushin standardet e caktuara të cilësisë, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Hartimi i këtij projektvendimi synon riorganizimin e veprimtarisë kërkimore shkencore të Akademisë, nëpërmjet riorganizimit të njësive kryesore të saj, duke transferuar të gjitha të drejtat dhe detyrimet tek Akademia e Shkencave e Shqipërisë (ASH), sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi, për shkak të rëndësisë së veçantë që ka fusha e albanologjisë në ruajtjen e zhvillimin e vlerave kombëtare.

Riorganizimi i njësive kryesore të ASA-së synon vijueshmërinë e kërkimit në fushat e historisë, të arkeologjisë, të antropologjisë kulturore e studimit të artit, të gjuhësisë e të letërsisë, etj., të cilat paraqesin një rëndësi të posaçme në ruajtjen e zhvillimin e vlerave kombëtare, si dhe hulumtimin, vlerësimin, konservimin dhe promovimin e trashëgimisë materiale e shpirtërore të kulturës së lashtë e të re shqiptare, si një ndër dëshmitë e qenësishme e më shprehëse të identitetit shqiptar.

Rishikimi i historisë dhe gjuhës së shqiptarëve në bazë të zbulimeve, të dhënave e studimeve të reja janë përgjegjësi kryesore e instituteve përkatëse në Shqipëri e Kosovë në fushën e historisë dhe gjuhës. Fjalorët e gjuhës shqipe të shoqëruar me ata dialektorë, tematikë e terminologjikë, rishikimi e pasurimi i tyre në vazhdimësi e koordinuar kjo nga një sektor i linguistikës pranë ASH, janë detyra themelore të këtyre institucioneve.

Gjithashtu, hartimi i enciklopedisë, vepër e cila prek të gjitha fushat e dijes e veçanërisht ato albanologjike kërkon një ndërveprim të përhershëm, sidomos midis institucioneve kryesore, si dhe krijimin e një njësie të përhershme siç është Qendra e Botimeve Enciklopedike dhe instituteve albanologjike. Kalimi i instituteve pranë ASH e lehtëson dhe e forcon këtë bashkëpunim të domosdoshëm.

Për sa më lart, bazuar në shkronjën “I”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për mbylljen e veprimtarisë së Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe riorganizimin e njësive kryesore të saj”

Republikën e Shqipërisë”, Ministria përgjegjëse për arsimin propozon mbylljen e veprimtarisë së Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe riorganizimin e njësive kryesore të saj.

II. VLERËSIMI I PROJEKTVENDIMIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektvendim është në përputhje të plotë me programin politik të Këshillit të Ministrave.

Ky projektakt është në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Arsimit, 2021-2026, të miratuar me vendimin nr. 621, datë 22.10.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Arsimit, 2021-2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj” (SKA 2021-2026). Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS), nëpërmjet kontrollit të pajtueshmërisë së veprimtarisë së institucioneve të arsimit të lartë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, synon garantimin e cilësisë në funksionimin e institucioneve të arsimit të lartë, plotësimin e standardeve ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës.

Rritja e cilësisë në arsimin e lartë është parashikuar edhe në objektivat specifike të Strategjisë Kombëtare për Arsimin, miratuar me vendimin nr. 621, datë 22.10.2021 të Këshillit të Ministrave, të sipërcituar, konkretisht objektivi specifik C.1 “Rritja e cilësisë së arsimit të lartë nëpërmjet riorganizimit të programeve të studimit, modernizimit të infrastrukturës akademike dhe aplikimit të standardeve të larta të vlerësimit institucional dhe të programeve të studimit”.

Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë ka evoluar për t’u bërë një nga përparësitë kryesore të politikave të arsimit të lartë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Aplikimi i proceseve të brendshme të sigurimit të cilësisë synon përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe të mësuarit në institucionet e arsimit të lartë. Ndërkaq, sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet nëpërmjet akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, bazuar në parashikimet e ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Akreditimi i IAL-ve dhe programeve në bazë të standardeve ndërkombëtare dhe mbikëqyrja e vazhdueshme e institucioneve dhe programeve të akredituara do të

garantojnë përmirësimin e përputhshmërisë të cilësisë së arsimit të lartë me standardet dhe udhëzuesit për sigurim të cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.

Projektvendimi është pjesë e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për t'u miratuar në vitin 2023, në zbatim të vendimit nr. 862, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2023”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTVENDIMIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Akademia e Studimeve Albanologjike, është krijuar me vendimin nr. 559, datë 22.8.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për bashkimin e disa instituteve të Akademisë së Shkencave, organizimin e tyre në Qendrën e Studimeve Albanologjike, si dhe funksionimin e kësaj qendre në periudhën kalimtare” i ndryshuar.

Në pikën 1, të këtij vendimi parashikohet: “1. Bashkimin e Institutit të Arkeologjisë, Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, Institutit të Kulturës Popullore, Institutit të Historisë, Qendrës Enciklopedike Shqiptare dhe Qendrës së Studimeve të Artit dhe organizimin e tyre në Qendrën e Studimeve Albanologjike (QSA), me statusin e personit juridik.”.

Me urdhrin nr. 296, datë 29.5.2018, të ministrit të Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, “Për miratimin e statutit të Akademisë së Studimeve Albanologjike” është miratuar statuti i Akademisë së Studimeve Albanologjike (sot ASA). Ky urdhër shfuqizonte statutin ekzistues të QSA-së.

Gjithashtu, në pikën 3, të urdhrin të sipërcituar, ASA ngarkohej që brenda afatit ligjor, të paraqiste të gjitha aktet dhe dokumentacionin ligjor për organet dhe autoritetet drejtuese, personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, sipas përcaktimeve të statutit.

Struktura akademike e ASA-së, referuar Statutit dhe rregullores së institucionit, aktualisht përbëhet nga 4 (katër) njësi kryesore të llojit institut, 12 (dymbëdhjetë) njësi bazë të llojit departament dhe 1 qendër kërkimore.

Struktura e Akademisë së Studimeve Albanologjike nuk është në përputhje me strukturën që përcakton ligji i arsimit të lartë për akademinë, pasi ASA nuk ka në përbërje asnjë fakultet si njësi kryesore. Konkretisht, në nenin 19, të ligjit nr.

80/2015, parashikohet se: “1. Akademia është institucion i arsimit të lartë i profilizuar, që vepron në fushën e arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe profesionale. 2. Akademia përfaqëson një strukturë të përbërë nga të paktën një fakultet. Në përputhje me fushën përkatëse të kompetencës, akademia mund të ofrojë programe të studimeve në të gjitha ciklet e studimit, si dhe programe studimi me karakter profesional. 3. Akademia mund të realizojë kërkim shkencor bazë dhe të zbatuar, shërbime, si dhe ushtron veprimtari të tjera, bazuar në këtë ligj dhe në statutin e saj”.

Për rrjedhojë, ky institucion nuk është i organizuar dhe nuk funksionon në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 80/2015.

Sa më sipër, nga ana e ministrisë përgjegjëse për arsimin, ASA-së i është bërë disa herë me dije se duhet të marrë masat për vijimin e procedurave të riorganizimit institucional, në përputhje me kriteret dhe procedurën e parashikuar në legjislacionin në fuqi.

Konkretisht me shkresën nr. 3681/2 prot., datë 10.7.2020, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, drejtuar ASA-së, citohet se: “Nga kontrollet e ushtruara nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Akademinë e Studimeve Albanologjike rezulton se institucioni nuk ka vijuar procesin e riorganizimit institucional edhe pas miratimit të statutit të akademisë me urdhrin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë me nr. 296, datë 29.5.2018, si akti bazë i nevojshëm për hapjen e fakultetit dhe programeve të ciklit të parë në këtë institucion.”

Në këtë shkresë po ashtu i bëhet me dije se: “Në konkluzion sqarojmë se, në zbatim të pikës 7, të nenit 39 dhe pikës 1 të nenit 131, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Dekretit nr. 10602, datë 31.8.2017, si dhe mospërfundimit të procesit të riorganizimit institucional brenda dy viteve të para akademike, Akademia e Studimeve Albanologjike nuk mund të jetë pjesë e procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë të vitit 2020”.

Pavarësisht mungesës së organizimit institucional në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 80/2015, ministria përgjegjëse për arsimin ka lejuar zhvillimin e procesit të zgjedhjeve në këtë institucion, me qëllim dhënien e mundësisë së funksionimit normal të procesit mësimdhënës dhe kërkimor-shkencor që duhet të realizojë një institucion i arsimit të lartë, si detyra thelbësore të përmbushjes së misionit të tij institucional, duke lejuar nëpërmjet urdhrit nr. 173, datë 22.06.2021 “Për procesin zgjedhor për autoritetet drejtuese në Akademinë e Studimeve

Albanologjike” zhvillimin e procesit të zgjedhjeve, por me kushtin që ASA menjëherë pas zhvillimit të procesit zgjedhor dhe konstituimit të organeve dhe autoriteteve drejtuese, të vijojë procesin e riorganizimit institucional, në përputhje me legjislacionin në fuqi, sa i përket njësive kryesore dhe njësive bazë, pjesë përbërëse të saj, ashtu edhe programeve të studimit që duhet të ofrojë kjo Akademi.

Aktualisht nga ky institucion nuk është vijuar me procedurat e riorganizimit të tij, pavarësisht rekomandimeve të vazhdueshme drejtuar ASA-së, sipas detyrave të lëna me anë të komunikimeve shkresore nga ministria, si dhe detyrimeve të urdhrit nr. 173, datë 22.06.2021, të sipërcituar.

Ky institucion ka aplikuar disa herë për akreditimin institucional nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Aseteve (AMS) ku kërkesa e parë për akreditim institucional është bërë nëpërmjet shkresës nr. 314 prot., 23.10.2018, me lëndë “*Kërkesë për akreditim institucional*” dhe pas komunikimeve të njëpasnjëshme me ASCAL lidhur me procedurën që duhet të ndiqet për akreditimin institucional nëpërmjet formularit që gjenerohet nga sistemi AMS, ASA ka aplikuar për akreditim nëpërmjet këtij sistemi në vitin 2020, nëpërmjet formularit datë 16.07.2020 dhe në vitin 2021, nëpërmjet formularit të datë 2.06.2021. Referuar komunikimeve me ASCAL, ASA-s i është kërkuar vazhdimisht plotësimi i mangësive strukturore në aplikim dhe nga ana e institucionit nuk ka pasur asnjë reagim lidhur me këto mangësi të konstatuara.

ASCAL, nëpërmjet shkresës nr. 268/1 prot., datë 27.07.2022, i ka kërkuar ASA-së vijimin e procesit të akreditimit institucional, si detyrim ligjor për çdo institucion dhe për të verifikuar përmbushjen e standardeve të cilësisë për akreditim.

Referuar sa më sipër, ASA vijon të mbetet i paakredituar, duke mos provuar plotësimin e standardeve të cilësisë që duhet të përmbushen nga institucionet e arsimit të lartë, si dhe duke moszbatuar detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 106, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet se: “1. Akreditimi institucional është procesi i certifikimit të cilësisë së veprimtarisë së institucioneve të arsimit të lartë, në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. 2. Akreditimi i programeve të studimit është procesi i certifikimit të cilësisë së tyre, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë. 3. Akreditimi i parë institucional dhe ai i programeve kryhen përpara lëshimit të diplomave të

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për mbylljen e veprimtarisë së Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe riorganizimin e njësive kryesore të saj”

para nga një institucion i arsimit të lartë. Akreditimi institucional i paraprin atij të programeve të studimit”.

ASA nuk ka të akredituara programet e studimit që ofronte/ofron ky institucion duke mos garantuar në këtë mënyrë plotësimin e standardeve të cilësisë edhe për programet e studimit që ofronte apo ofron. Me lëshimin e diplomave pa realizuar akreditimin institucional dhe atë të programeve të studimit, institucioni është në shkelje të pikës 3, të nenit 106 të ligjit nr. 80/2015, ku përcaktohet se:

“3. Akreditimi i parë institucional dhe ai i programeve kryhen përpara lëshimit të diplomave të para nga një institucion i arsimit të lartë. Akreditimi institucional i paraprin atij të programeve të studimit.”.

Gjithashtu, referuar kontrollit të dokumentacioneve të vëna në dispozicion, rezultojnë mospërputhje midis organigramës, strukturës dhe rregullores së ASA-së, sa i përket emërimit dhe përbërjes së njësive përbërëse.

ASA, që prej vitit 2018, nuk rezulton të ketë kryer veprimtarinë akademike në përputhje me përcaktimet e statutit të miratuar me urdhrin nr. 296, datë 29.5.2018, të ministrit të MASR, *“Për miratimin e statutit të Akademisë së Studimeve Albanologjike”.*

Referuar gjetjeve dhe konstatimeve të shkeljeve që përbëjnë mosplotësim të kushteve të organizimit institucional, akreditimit institucional dhe programeve të studimit, si dhe bazuar në ligjin nr. 80/2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*, nëngrupi i punës, i ngritur me urdhrin nr. 727, datë 07.12.2022, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit *“Për ngritjen e nëngrupeve të punës për realizimin e kontrollit të pajtueshmërisë së veprimtarisë së institucioneve të arsimit të lartë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi”*, i ndryshuar, hartoi projekt-raportin me gjetjet e konstatuara pas ushtrimit të kontrollit të pajtueshmërisë së veprimtarisë së këtij institucioni me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, i cili do t'i përcillej për objeksione ASA-së, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Në përgjigje të projekt-raportit të hartuar dhe miratuar nga grupet e punës dhe strukturat përgjegjëse në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Akademia e Studimeve Albanologjike me shkresën nr. 50/3 prot., datë 3.4.2023, protokolluar në MAS me nr. 629/4 prot., datë 4.4.2023, me lëndë *“Dërgohet relacioni me komente mbi raportin e VKL”*, ka përcjellë objeksionet dhe reflektimet për gjetjet e konstatuara në projekt-raport.

Pas vlerësimit të objeksioneve dhe reflektimeve të ASA-s, nëngrupi i punës, i ngritur me urdhrin nr. 727, datë 07.12.2022, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, të ndryshuar, i propozoi Grupit të Punës, të ngritur me urdhrin nr. 691, datë 16.11.2022 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për realizimin e kontrollit të pajtueshmërisë së veprimtarisë së institucioneve të arsimit të lartë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi”, si më poshtë:

“Akademia e Studimeve Albanologjike deri në momentin e ushtrimit të kontrollit të ligjshmërisë nuk ka funksionuar dhe nuk ka ushtruar veprimtarinë akademike si institucion i arsimit të lartë i llojit “akademi”, në përputhje me ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Në zbatim të pikës 5, të urdhrin nr. 173, datë 22.6.2021, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për procesin zgjedhor për autoritetet drejtuese në Akademinë e Studimeve Albanologjike”, ku përcaktohet “Menjëherë pas zhvillimit të procesit zgjedhor dhe konstituimit të organeve dhe autoriteteve drejtuese, Akademia e Studimeve Albanologjike të vijojë procesin e riorganizimit si institucion i arsimit të lartë në zbatim të nenit 129, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe të hartojë planin e veprimit për riorganizimin në llojin e institucionit të arsimit të lartë “Akademi”, sipas vendimmarrjes së organeve të saj të brendshme. Akademia e Studimeve Albanologjike të ndjekë me prioritet vijimin e punës për riorganizimin e saj, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, si për sa i përket njësive kryesore dhe njësive bazë, pjesë përbërëse të saj, ashtu dhe programeve të studimit që do të ofrojë kjo Akademi”, Akademia e Studimeve Albanologjike nuk ka marrë asnjë masë për t’u riorganizuar si institucion i arsimit të lartë i llojit “akademi” në përputhje me ligjin nr. 80/2015.

Për sa më lart, rekomandojmë mbylljen e veprimtarisë së këtij institucioni si institucion i arsimit të lartë të llojit “akademi” dhe riorganizimin e njësive përbërëse të tij në një formë tjetër ligjore, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi, për shkak të rëndësisë së veçantë që ka fusha e albanologjisë në ruajtjen e zhvillimin e vlerave kombëtare.

Në zbatim të shkronjës “c”, të pikës 3, të urdhrin nr. 727, datë 7.12.2022, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, “Për ngritjen e nëngrupeve të punës për realizimin e kontrollit të pajtueshmërisë së veprimtarisë së institucioneve të arsimit të lartë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi”, i ndryshuar, Grupi i Punës vlerëson dhe merr vendim mbi raportin e hartuar nga

nëngrupi i punës bashkë me rekomandimet për Akademinë e Studimeve Albanologjike”.

Grupi i Punës, në ushtrim të detyrave të ngarkuara në zbatim të urdhrit nr. 691, datë 16.11.2022 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për realizimin e kontrollit të pajtueshmërisë së veprimtarisë së institucioneve të arsimit të lartë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi”, ku në bazë të pikës 6 të tij ka detyrimin t’i paraqesë Ministrit përgjegjës për arsimin raportin përfundimtar të çdo nëngrupi pune, pas realizimit të procesit të vlerësimit dhe vendimmarrjes, miratoi propozimet e nëngrupit të punës dhe procedoi me dërgimin e raportit përfundimtar për miratim te Ministri përgjegjës për arsimin.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektvendim është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, shkronjës “I”, të pikës 2, të nenit 7 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 19 të ligjit nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk lidhet me çështjet e përafrimit të legjislacionit me Acquis Communautaire.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Akademia e Studimeve Albanologjike, është krijuar me vendimin nr. 559, datë 22.8.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për bashkimin e disa instituteve të Akademisë së Shkencave, organizimin e tyre në Qendrën e Studimeve Albanologjike, si dhe funksionimin e kësaj qendre në periudhën kalimtare” i ndryshuar.

Projektvendimi “Për mbylljen e veprimtarisë së Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe riorganizimin e njësive kryesore të saj”, parashikon mbylljen e Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe riorganizimin e njësive kryesore të saj, si dhe rregullimin e pasojave me mbylljen e veprimtarisë së saj, në

përputhje me përcaktimet në shkronjën “a” të pikës 6 të vendimit nr. 418, datë 10.05.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre”, ku parashikohet se:

“a) Mbyllja e IAL-së bëhet, në çdo rast, me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës të arsimit të lartë, ndërsa mbyllja e degëve të IAL-ve bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin e lartë. Vendimi përkatës i Këshillit të Ministrave dhe urdhri përkatës i ministrit përgjegjës për arsimin e lartë përcaktojnë pasojat dhe detyrimet që lindin, përkatësisht, nga mbyllja e IAL-së/ve ose degëve të tyre.”

Ky projektvendim përbëhet nga 6 (gjashtë) pika me përmbajtjen, si më poshtë:

Në pikën 1 të projektvendimit, parashikohet mbyllja e veprimtarisë së Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe transferimin e të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të saj tek Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

Në pikën 2 të projektvendimit, përcaktohet se njësitë kryesore ekzistuese, Qendra Kërkimore e Enciklopedisë Shqiptare dhe Botimeve dhe personeli akademik i këtyre njësive, aktualisht pranë Akademisë së Studimeve Albanologjike, riorganizohen si njësi të kërkim-studimit pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, brenda datës 31 Dhjetor 2023.

Në pikën 3 të projektvendimit përcaktohet se të gjitha asetet, pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në administrim të Akademisë së Studimeve Albanologjike, kalojnë në administrim të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, e cila ka detyrimin t’i ruajë dhe t’i mirëmbajë pasuritë në administrim dhe nuk mund të ndryshojë apo tjetërsojë destinacionin e tyre.

Në pikën 4 të projektvendimit përcaktohen detyrimet e Akademisë së Studimeve Albanologjike, si më poshtë:

- a) Të marrë të gjitha masat për transferimin e studimeve për doktorantët e pa diplomuar në ciklin e tretë të studimeve, për fitimin e gradës shkencore “Doktor”, që plotësojnë kriteret ligjore për transferimin e studimeve, në institucione të tjera të arsimit të lartë, vendase apo të huaja, që ofrojnë programe studimi në fusha të njëjta apo të ngjashme.

- b) Të përgatitë dosjen për çdo doktorant, që plotëson kriteret ligjore për transferimin e studimeve, me dokumentacionin e nevojshëm dhe t'ia vendosë në dispozicion doktorantëve, pa detyrim financiar shtesë nga ana e tyre, brenda datës 31 Gusht 2023.
- c) Të përcjellë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dosjet e doktorantëve që nuk do të tërhiqen nga doktorantët përkatës, brenda datës 08 Shtator 2023.
- d) Të dorëzojë dokumentacionin ligjor, administrativ, financiar dhe akademik që disponon dhe mbi bazën e të cilit ka zhvilluar veprimtarinë e saj akademike dhe kërkimore-shkencore, në strukturat përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi për arkivat.
- e) Të vendosë në dispozicion të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë vendim.

Në **pikën 5** të projektvendimit parashikohet se Akademia e Studimeve Albanologjike duhet të marrë masa që të vijojë ushtrimin e veprimtarisë së saj deri në transferimin e plotë të njësive përbërëse pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

Në **pikën 6** të projektvendimit parashikohen institucionet që ngarkohen me zbatimin e këtij vendimi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTVENDIMIT

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Kulturës, Akademia e Shkencave të Shqipërisë dhe Akademia e Studimeve Albanologjike.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTVENDIMIT

Për hartimin e këtij projektvendimi kontribuoi Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe strukturat përgjegjëse të saj.

Projektvendimi dërgohet për mendim te Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Kulturës nëpërmjet sistemit *e-akte*, si dhe tek Akademia e Shkencave e Shqipërisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektvendimi nuk paraqet efekte financiare shtesë për Buxhetin e Shtetit.

PROPOZUESI

MINISTËR

EVIS KUSHI